

- 50 -

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 4 Date 06.04.2010

“PER
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TE POSACEM
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne piken 9, kreu XI, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, dhe nenit 18 germa dh, te ligjit nr.8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Autorizimit te posacem per Perdorim te Rezerves Ujore te Lumit Dardhe, komuna Blerim, rrethi Puke, per HEC Dardhe, per prodhim hidroenergjie, subjektit “WEnerg”sh.a. dhe “Compagnie Nationale du Rhone” e cila ka nenshkruar Kontraten e Koncesionit me autoritetin kontraktues me date 18.08.2009, bazuar ne miratimin e marre ne V.K.M.nr.708 dt. 21.05.2008, mbasi subjekti ka depozituar prane A.U.B. Drin-Bune kerkesen dhe kopjen e Kontrates se Koncesionit per HEC-in qe do te ndertoje.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PERGJEGJESI I A.U.B.

DRIN-BUNE

Xhelal BAJRAKTARI



KRYETARI I K.B.U.

DRIN-BUNE

Maxhid CUNGU

